REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 498/25 Dt. 14.08.2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja b, d dhe g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për formimin e Komisionit

1. Themelohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave të ardhur nga fermerët të cilët kanë aplikuar në bazë të thirrjes për projektin: "Hapja e puseve për ujitjen e tokave bujqësore" me bashkëfinancim. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:

   1.1. Azem Bilibani,..... kryesues,
   1.2. Galip Belallari,..... anëtar,
   1.3. Veton Xhemaj,.....anëtar.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit nga pika 1 e këtij Vendimi janë: të shqyrtoj, vlerësoj dhe vendos të gjitha ankesat e ardhura nga ana e fermerëve të cilët kanë aplikuar në bazë të thirrjes për projektin: "Hapja e puseve për ujitjen e tokave bujqësore", me bashkëfinancim, dhe të njëjtit nuk janë shpallur fitues nga ana e Komisionit që ka bërë vlerësimin dhe shqyrtimin e aplikacioneve të fermerëve në bazë të thirrjes për projektin e lartcekur.

3. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

4. Obligohet Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Komisioni i lartcekur për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,
- Komisionit të lartcekur,
- Arkivës së Kryetarit.